



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, nenit 61 paragrafi 1.8 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, në zbatim të Planit të Veprimit për Transparencë për periudhën 2019 – 2023 në Komunën e Podujevës si dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-060/01-0055328/20 të datës 09 shtator 2020, , në pajtim me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-060/01-0055328/20 të datës 09 shtator 2020, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2021, miratoi këtë,

VENDIM PËR VËNIEN NË DISKUTIM

Neni 1

Vëhet në diskutim publik:

- **Propozim Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës**

Neni 2

1. Diskutimi publik sipas nenit 1, zgjat nga data **05 maj 2021 deri më 07 qershor 2021**, ndërsa debatet publike mbahen në 5 lokalitete të ndryshme, dhe atë:

- 1.1. Debati publik me banorët e fshatit Kërpimëh dhe fshatrat përreth mbahet më 11 maj 2021 duke filluar nga ora 14:00, në shkollën e fshatit Kërpimëh.**
- 1.2. Debati publik me banorët e fshatit Lluzhan dhe fshatrat përreth mbahet më 12 maj 2021 duke filluar nga ora 14:00, në shkollën e fshatit Lluzhan.**
- 1.3. Debati publik me banorët e fshatit Sfeçël dhe fshatrat përreth mbahet më 17 maj 2021 duke filluar nga ora 14:00, në shkollën e fshatit Sfeçël.**
- 1.4. Debati publik me banorët e fshatit Orllan dhe fshatrat përreth mbahet më 18 maj 2021 duke filluar nga ora 14:00, në shkollën e fshatit Orllan.**
- 1.5. Debati publik me banorët e fshatit Gllmanik dhe fshatrat përreth mbahet më 19 maj 2021 duke filluar nga ora 14:00, në shkollën e fshatit Gllmanik.**
- 1.6. Debati publik (1) me banorët e qytetit të Podujevës mbahet më 20 maj 2021 duke filluar nga ora 14:00, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit – ndërtesa e re e Komunës.**
- 1.7. Debati publik (2) me banorët e qytetit të Podujevës mbahet më 21 maj 2021 duke filluar nga ora 14:00, në shkollën fillore “Xheladin Rekalii”**

Neni 3

Propozimet, sugjerimet, apo vërejtjet eventuale paraqiten ditën e mbajtjes të debatit publik, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së diskutimit publik në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, ndërtesa e re e Komunës zyra nr.54, si dhe në formë elektronike mund të dërgohen në e-mail adresat; nazmi.elezi@rks-gov.net dhe latif.mehmeti@rks-gov.net; të cilat pastaj përcjellën në Drejtorinë përkatëse, brenda periudhës së diskutimit publik.

Neni 4

Dokumenti sipas nenit 1, është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe i njëjti publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve> (rubrika; aktet për diskutim publik)

Neni 5

Diskutimi publik zbatohet nga Drejtoria e Administratës në bashkëpunim dhe koordinim me Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, dhe Koordinatorin për fshatra, që përkujdeset për përgatitjen e raportit nga diskutimi / debati publik dhe të jap sqarime për arsyeshmërinë e pranimi ose mospranimi të propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.

Neni 6

1. Vendimi hyn në fuqi pas publikimit ueb faqen zyrtare të Komunës.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, anulohen procedurat që kanë rrjedhë sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-020/08-0060972/18 të datës 31 korrik 2020, për shkak të nxjerrjes së Udhëzimit të ri Administrativ nr.02/2019 MAPL.

Nr.01-016/01-0035813/21

**Podujevë,
29 prill 2021**



Arsyetim

Propozim Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës, është proceduar në Kuvendin e Komunës për marrjen e miratimit për vënie në diskutim publik në mbledhjen e mbajtur më 09 shtator 2020, mirëpo sipas vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-060/01-0055328/20, për propozim Rregulloren në fjalë është dhënë mbështetje nga ana e Kuvendit mirëpo meqë masat anti Covid -19 të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës nuk lejonin grumbullime të tilla të qytetarëve në atë kohë, Kuvendi i Komunës ka vendosur, si në vijim;

Diskutimi publik, për shkak të situatës së krijuar nga Pandemia Covid-19 dhe pamundësisë së mbajtjes së tubimeve publike me komunitetet e fshatrave dhe lagjeve urbane, pezullohet në kohë të pacaktuar, përkatësisht deri në përmirësimin e situatës epidemiologjike dhe krijimit të kushteve për organizimin dhe mbajtjen e tubimeve publike, që do të caktohet me një vendim tjetër nga Kuvendi i Komunës.

Andaj, duke marrë për bazë lehtësimin e masave dhe mundësisë së mbajtjes së debateve publike në këtë periudhë, konsiderohet se është e mundshme të organizohen debate në lokalitete të ndryshme të Komunës së Podujevës, por kërkohet që me këtë propozim vendim, Kuvendi i Komunës të caktoj kohëzgjatjen e diskutimit publik, datat dhe lokalitetet e mbajtjes së debateve publike për Propozim Rregulloren për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës sipas dokumentit të proceduar dhe shqyrtuar në Kuvendin e Komunës më 09 shtator 2020.



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT

PROPOZIM

RREGULLORE
PËR ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME
FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE
NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS

Podujevë,
gusht 2020

Në bazë të neneve 11, 12 paragrafi 12.2 shkronja c) dhe nenit 34 paragrafi 34.4 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, nenet 14, 15 paragraf 2.3 dhe nenit 29 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, Në pajtim me Shkresën e MAPL nr.prot.02-129/2 të datës 06.02.2020, Nënkryetari i Komunës së Podujevës, Kuvendit të Komunës, i

Propozon

**RREGULLORE
PËR ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME
FSHATRA, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE
NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS**

Neni 1

Qëllimi

Rregullorja ka për qëllim rregullimin e organizimit dhe bashkëpunimit të komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Podujevës, në ushtrimin e aktiviteteve që janë ekskluzivisht në kompetencë vetanake të Komunave, të përcaktuara me ligjin për vetëqeverisjen lokale.

Neni 2

Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin si në vijim:

Komuna - njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Kosovë.

Territori – nënkupton vendbanimet, qytetin, lagjet urbane dhe fshatrat që shtrihen në zonat kadastrale brenda kufijëve të Komunës së Podujevës sipas Ligjit për kufijt administrativ të Komunave dhe Ligjit për kadastër.

Këshillat lokale – nënkupton trupat e zgjedhur që përfaqësojnë në mënyrë të organizuar komunitetin e një apo më shumë fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

Kryetar i këshillit – nënkupton personin më të votuar në tubim zgjedhor në fshatra, vendbanime dhe lagje urbane.

Neni 3

**Themelimi i komisionit për zgjedhjen e
këshillave lokale**

1. Kuvendi i Komunës themelon komision për të koordinuar procesin e zgjedhjes së këshillave lokale.
2. Komisioni përbëhet prej 7 (shtatë) anëtarëve dhe reflekton përfaqësimin gjinor dhe etnik, dhe atë
- 4 (katër) anëtarë/e nga Kuvendi i Komunës nga subjektet e ndryshme politike,
- 1 (një) anëtar/e nga Ekzekutivi, që propozohet nga Kryetari i Komunës,
- 1 (një) anëtar/e nga shoqëria civile, i/e nominuar nga shoqëria civile,
- 1 (një) anëtar/e përfaqësues përkatës i fshatit, vendbanimit apo lagjës urbane.
3. Kryesuesi i komisionit zgjedhet nga anëtarët e komisionit.
4. Në aspektin teknik, administrativ dhe profesional, komisioni bashkëpunon me nëpunësin civil - koordinatorin për bashkëpunim me këshillat lokale.

5. Komisioni koordinon punën dhe cakton periudhën kohore të mbajtjes së tubimeve të banorëve, për zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokale dhe kryetarëve të këshillave lokale të cilët duhet të jenë rezident.

6. Së paku katër (4) anëtarë të komisionit duhet të jenë të pranishëm në secilin tubim zgjedhor që organizohet për zgjedhjen e anëtarëve dhe kryetarëve të këshillave lokale.

7. Pjesëmarrësit në tubimet zgjedhore mund të paraqesin ankesat e tyre, nëse konsiderojnë se ka pasë pa rregullësi gjatë procesit zgjedhor përkatës. Komisioni obligohet që të njëjtat ti shqyrtojë brenda afatit prej 15 ditëve nga data e paraqitjes si dhe t'iu kthejë përgjigje me shkrim.

8. Komisioni, përmes Zyrës për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, informon banorët përkatës 15 ditë para datës së mbajtjes së tubimit për zgjedhjen e këshillave lokale, përmes:

shpalljeve publike të vendosura në objektet publike dhe vendet më të frekuentuara brenda territorit ku mbahet tubimi zgjedhor:

mediave lokale;

ueb - faqes zyrtare të komunës

rrjeteve sociale

Njoftimi domosdo duhet të përmbajë: rendin e ditës, datën, kohën, vendin e mbajtjes së tubimit.

9. Mandati i komisionit është i lidhur me mandatin e Kuvendit të Komunës.

10. Komisioni për procesin zgjedhor i raporton Kuvendit të Komunës pas përfundimit të tërë procesit.

Neni 4

Themelimi i këshillave lokale

1. Në territorin e Komunës së Podujevës themelohen këshillat lokale përkatësisht 6 këshilla lokale urbane dhe 24 Këshilla lokale të fshatrave, si në vijim:

1.1. **Këshilli lokal urban : Qendra 1**, me përkufizimin e tekstual të territorit si vijon: përfshinë territorin duke filluar nga: (rruga, rreth rrotullime udhëkryqe etj.....)

1.2. **Këshilli lokal urban: Qendra 2 Veri**, me përkufizimin e tekstual të territorit si vijon: përfshinë territorin duke filluar nga: (rruga, rreth rrotullime udhëkryqe etj.....)

1.3. **Këshilli lokal urban: Qendra 2 Jug**, me përkufizimin e tekstual të territorit si vijon: përfshinë territorin duke filluar nga: (rruga, rreth rrotullime udhëkryqe etj.....)

1.4. **Këshilli lokal urban: Qendra 3 Veri**, me përkufizimin e tekstual të territorit si vijon: përfshinë territorin duke filluar nga: (rruga, rreth rrotullime udhëkryqe etj.....)

1.5. **Këshilli lokal urban: Qendra 3 Jug**, me përkufizimin e tekstual të territorit si vijon: përfshinë territorin duke filluar nga: (rruga, rreth rrotullime udhëkryqe etj.....)

1.6. **Këshilli lokal urban: Qendra Kopshti Lindor**, me përkufizimin e tekstual të territorit si vijon: përfshinë territorin duke filluar nga: (rruga, rreth rrotullime udhëkryqe etj.....)

1.7. **Këshilli lokal i fshatrave: Pollatë, Murgull, Tërnavicë, Zhiti, Brecë, Reçicë, Sllatinë, Potok, Dvorishtë**

1.8. **Këshilli lokal i fshatrave: Kërpimëh, Metehi, Repë, Sylevicë**

1.9. **Këshilli lokal i fshatrave: Revuçë, Pakashticë e Epërme, Pakashticë e Poshtme**

1.10. **Këshilli lokal i fshatrave: Bajcinë, Dobërdol, Zakut**

- 1.11. Këshilli lokal i fshatrave: Obrancë, Peran, Bradash, Dobratin
- 1.12. Këshilli lokal i fshatrave: Llapashticë e Epërme, Llapashticë e Poshtme, Velikarekë
- 1.13. Këshilli lokal i fshatit: Gllamnik.
- 1.14. Këshilli lokal i fshatrave: Siboc i Epërm, Siboc i Poshtëm
- 1.15. Këshilli lokal i fshatrave: Kunushec, Buricë, Penuhë, Godishnjak
- 1.16. Këshilli lokal i fshatrave: Orllan, Turuçicë, Rakinicë, Kushevicë
- 1.17. Këshilli lokal i fshatrave: Sallabajë, Shakovicë,
- 1.18. Këshilli lokal i fshatrave: Lluzhan , Llugë
- 1.19. Këshilli lokal i fshatrave: Lupç i Poshtëm, Majac, Lupç i Epërm, Popovë
- 1.20. Këshilli lokal i fshatrave: Bellopojë, Dyz
- 1.21. Këshilli lokal i fshatrave: Tërnavë, Halabak
- 1.22. Këshilli lokal i fshatrave: Gërdoc, Kaçybeg
- 1.23. Këshilli lokal i fshatit: Batllavë, Barainë, Radujevë
- 1.24. Këshilli lokal i fshatrave: Brainë, Kalaticë, Bërvenik, Metergoc, Bllatë, Muhazob
- 1.25. Këshilli lokal i fshatrave: Shajkoc, Dumosh
- 1.26. Këshilli lokal i fshatrave: Sfeçël, Surkish
- 1.27. Këshilli lokal i fshatrave: Balloc, Lladoc, Herticë, Surdull,
- 1.28. Këshilli lokal i fshatrave: Shtedim, Miroc, Livadicë, Merdar
- 1.29. Këshilli lokal i fshatit: Dumnicë e Poshtme
- 1.30. Këshilli lokal i fshatrave: Llaushë, Dumnicë e Eperme, Përpellac

Harta (ortofoto) e këshillave urbane dhe këshillave lokale të fshatrave, me emërtime sipas këtij neni.

(Vendoset pas diskutimit publik)

2. Këshillat lokale urbane përmbajnë emërtimin e rrugëve sipas tabelës në shtojcë të kësaj Rregulloreje.

Neni 5

Përbërja e këshillave lokale dhe kriteret e përzgjedhjes

1. Këshilli lokal mund të ketë prej 5 (pesë) deri në 9 (nëntë) anëtarë/e. Numri i saktë i antarëve për secilin këshill lokal, përcaktohet nga vetë banorët e fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane që janë të pranishëm në tubimin zgjedhor.
2. Çdo fshat vendbanim apo lagje urbane duhet të jetë i përfaqësuar në këshillin lokal.
3. Përbërja e këshillave lokale duhet të reflektojë përbërjen etnike dhe gjinore. Përfaqësimi gjinor duhet të jetë sipas Ligjit përkatës për barazi gjinore. Në rast se në fshat, vendbanim apo lagje urbane, jetojnë pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë, duhet të jenë të përfaqësuar në këshillin lokal nëse janë të pranishëm në tubim.
4. Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të komunës zgjedhin anëtarët e këshillit lokal, në tubimin zgjedhor ku pjesëmarrës janë gjithë banorët e moshës madhore të interesuar të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane.
5. Tubimin e udhëheq një përfaqësues i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane i cili përzgjedhet nga shumica e pjesëmarrësve në tubimin zgjedhor.
6. Zgjedhja bëhet përmes votimit të hapur apo votimit të fshehtë në tubimin zgjedhor, varësisht përcaktimit nga shumica e pjesëmarrësve.
7. Të drejtë vote kanë të gjithë banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane përkatëse, mbi moshën 18 vjeqare.

8. Kandidatët për anëtarë të këshillave lokale dhe kryetarët e këshillave lokale duhet të jenë banorë të përhershëm në atë lokalitet si dhe nuk mund të kandidohen në emër të ndonjë partie politike.
9. Kandidatët për pozita të anëtarëve dhe të kryetarëve të këshillave lokale, nuk mund të kandidohen nëse janë të zgjedhur apo emëruar në poste politike.
10. Anëtarë të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve apo lagjeve urbane, zgjedhen kandidatët të cilët fitojnë numrin më të madh të votave nga numri i përgjithshëm i banorëve të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane që janë prezent në tubimin zgjedhor.
11. Kryetari i këshillit lokal zgjedhet nga radhët e anëtarëve të këshillit lokal të fshatit/rave, vendbanimit/eve apo lagjes/ve urbane, kandidati i cili fiton shumicën e votave të pjesëmarrësëve në tubim. Nëse në rrethin e parë të votimit kemi dy apo më shumë kandidatë me numër të barabartë të votave atëherë organizohet rrethi dytë i votimit dhe kandidati që merr më shumë vota zgjedhet për anëtar, kryetar të këshillit lokal.
12. Anëtarët dhe kryetarët e këshillave lokale të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, zgjedhen me mandat 4 vjeçar me mundësi rizgjedhje edhe për një mandat sipas procedurave të njëjta.
13. Tubimet kanë legjitimitet nëse në tubim janë të pranishëm së paku 31 pjesëmarrës me të drejtë vote duke respektuar ligjin për barazi gjinore.

Neni 6

Ndërprerja dhe përfundimi i mandatit të kryetarëve dhe anëtarëve të këshillave lokale

1. Në rastet kur banorët konsiderojnë që kryetari, anëtarët apo ndonjëri nga anëtarët e këshillit lokal nuk i ka përmbushë obligimet që dalin nga kjo rregullore, të njëjtëve mund t'u ndërpritet mandati me shumicë të votave të banorëve të lokaliteteve të përfaqësuara në këshill përmes një tubimi publik.
2. Procedura e ndërprerjes së mandatit sipas paragrafit paraprak bëhet me iniciativë të më shumë se gjysma e numrit pjesëmarrës sa kanë qenë në tubimin zgjedhor ku është zgjedhur kryetari apo anëtarët e këshillit lokal.
3. Iniciativa duhet të përmbajë nënshkrimet dhe e njëjta në formë të kërkesës procedohet te komisioni i formuar sipas nenit 3, përmes Drejtorisë së Administratës dhe zyrës së Kuvendit.
4. Pas pranimit të kërkesës komisioni brenda afatit prej 30 ditësh koordinon dhe mban procesin e tubimit përkatës.
5. Mandati i kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokal përfundon:
 - 5.1. me kryerje të mandatit;
 - 5.2. nëse jep dorëheqje;
 - 5.3. nëse shkarkohet;
 - 5.4. nëse ndërron vendbanim;
 - 5.5. në rast të dënimit për veprë penale me një urdhër për burgim për gjashtë (6) muaj
 - 5.6. nëse vdes;
6. Në rast të humbjes së mandait të kryetarit të këshillit, komisioni brenda 30 ditësh duhet të organizojë zgjedhjet për zgjedhjen e kryetarit të ri.
7. Zëvendësimi i anëtarëve të këshillit në rastin e humbjes apo ndërprerjes së mandatit bëhet nga lista e pritjes me aprovimin e komisionit të Kuvendit brenda 15 ditësh.

8. Nëse për çfarëdo arsye nuk mund të bëhet zëvendësimi i anëtarit/ve nga lista e pritjes atëherë komisioni organizon zgjedhjet për zgjedhjen e anëtarit apo anëtarëve të këshillit sipas procedurës së rregullt.

Neni 7

Procesverbali nga tubimi zgjedhor

1. Procesverbali i hartuar nga tubimi i qytetarëve, duhet të përmajë; datën vendin, orën e mbajtjes së tubimit, numrin e pjesëmarrësve (lista e nënshkruar e pjesëmarrësve), që kanë marrë pjesë në tubim, të dhënat për zgjedhjen e anëtarëve dhe kryetarëve të këshillave lokale, procedurat e votimit dhe çështje të tjera të adresuara në takim.
2. Procesverbalin e nënshkruajn. anëtarët e komisionit komunal, procesmbajtësi, kryetari dhe anëtarët e zgjedhur të këshillit, ndërsa komisioni i përcaktuar sipas nenit 3 të kësaj rregulloreje i raporton Kuvendit të Komunës për rrjedhën e tubimeve, procesin e zgjedhjeve të kryetarëve dhe anëtarëve të këshillave lokale.
3. Rezultatet e zgjedhjeve, emrat e anëtarëve, kryetarit të këshillit lokal duhet të bëhen publike nga ana e komisionit komunal përmes Zyrës për marrëdhënie me publikun dhe informim.

Neni 8

Konsultimet ndërmjet komunës dhe këshillave lokale

1. Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendi të Komunës dhe zyrtari përkatës për bashkëpunim me këshilla lokale , ftojnë këshillat lokale që të marrin pjesë në tubimet publike me qytetarë, në dëgjimet publike për buxhet, tubimet e rregullta publike, takimet për planifikim të politikave zhvillimore komunale që organizohen nga organet komunale, përkatësisht Kuvendi i Komunës apo Kryetari.
2. Kryetari i Komunës duhet që së paku të organizojë dy takime në vit me kryetarët e këshillave lokale. Takimet duhet të mbahen së paku një herë në gjashtë muaj.
3. Kuvendi i Komunës mund të kërkojë një opinion nga këshilli lokal, në çështje të caktuara me interes për komunitetin.

Neni 9

Roli, detyrat dhe aktivitetet e këshillave lokale

1. Këshilli lokal mund të takohet në çdo kohë për të shqyrtuar çështjet në interes të lokalitetit si dhe harton dhe miraton planin e punës.
2. Këshilli lokal, organizon, përcjell dhe planifikon planet dhe programet zhvillimore të lokalitetit, në të gjitha sferat në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, Kryesuesin e Komunës, Komitetet dhe Drejtoritë e Komunës.
3. Këshilli lokal duhet të informojë komunën, përkatësisht Zyrtarin përgjegjës për bashkëpunim dhe koordinim me këshillat lokale, për kohën dhe agjendën e takimeve. Zyrtarët komunal mund të marrin pjesë në takimet e organizuara nga këshillat lokale.
4. Takimet e banorëve të lokaliteteve përkatëse mund të organizohen me iniciativën e këshillit lokal përkatës.
5. Organizon aksione vullnetare në interes për lokalitetin;
6. Këshillat lokale kanë të drejtë të bashkëpunojnë në mes veti në territorin e komunës.
7. Këshillat lokale mund t'i parashtrojnë organeve dhe Drejtorive të Komunës, kërkesë me shkrim për çështje të ndryshme në interes të lokalitetit kurse organet përkatëse të Komunës brenda afatit prej 30 ditë i përgjigjen me shkrim këshillit lokal që e ka parashtruar kërkesën.

Neni 10

Bashkëpunimi i Komunës me këshillat lokale

1. Komuna bashkëpunon me këshillin lokal në çështjet që ndërlidhen me :
 - 1.1. Planifikimin urban dhe rural të lokalitetit;
 - 1.2. Furnizimin me ujë, rregullimi i kanalizimit, drenazhimin;
 - 1.3. Shëndetësinë publike;
 - 1.4. Mbrojtjen lokale të ambientit;
 - 1.5. Turizmin;
 - 1.6. Hapësirave publike dhe varrezave;
 - 1.7. Zhvillimin e turizmit;
 - 1.8. Aktiviteteve kulturore dhe sportive etj;

Neni 11

Marrëveshja e bashkëpunimit i Komunës me këshillat lokale

1. Komuna ka të drejtë të nënshkruaj marrëveshje bashkëpunimi me këshillin lokal, në çështjet që janë në kompetencë të Komunës, me përjashtim të atyre që janë në kuadër të përgjegjësisë së Kuvendit të Komunës neni 40.2 të Ligjit për vetqeverisjen lokale.
2. Marrëveshja duhet të përmbajë së paku këto elemente: Objektin e marrëveshjes; Kohëzgjatjen; obligimet e palëve; Dinamikën e realizimit të punëve; Koston financiare;
3. Marrëveshjet nënshkruhen nga Kryetari i Komunës përveç nëse Kryetari me autorizim e delegon këtë të drejtë në Drejtoritë përkatëse dhe Kryetarit të këshillit lokal me pëlqimin paraprak të shumicës së anëtarëve të këshillit.

Neni 12

Konsultimet e Komunës me këshillat lokale

1. Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Kryesuesin e Kuvendit organizojnë së paku dy takime në vit me Kryetarët e këshillave lokale.
2. Kryetarët e këshillave lokale, ftohen të marrin pjesë në takime konsultative, debate publike dhe konsultime publike.
3. Komuna duhet të konsultojë këshillin lokal, në çështje të caktuara me interes vital për komunitetin përkatës.

Neni 13

Roli i kryetarit të këshillit lokal

1. Kryetari i këshillit përfaqëson këshillin lokal në konsultimet dhe diskutimet me organet Komunale.
2. Kryetari i këshillit lokal thërret dhe udhëheq me mbledhjet e këshillit lokal dhe kujdeset për organizimin dhe punën e këshillit. Poashtu, ai i nënshkruan dokumentet e miratuara nga ana e këshillit lokal dhe është i obliguar që në afat prej 15 ditëve, nga dita e miratimit të tyre, t'i dorëzojë te organet përkatëse të Komunës.

Neni 14

Financimi i aktiviteve

1. Aktivitetet e këshillave lokale dhe projektet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në mes komunës dhe këshillave lokale mund të financohen si vijon;
 - Banorët e fshatit vendbanimit apo lagjes urbane,
 - Komuna përkatëse,
 - Donatorët dhe
 - Financim të përbashkët.
2. Këshilli përgatit raportin gjashtëmuor dhe raportin vjetor për të gjitha aktivitetet dhe projektet e realizuara dhe me të njëjtin e informon Kryetarin e Komunës.

Neni 15

Kompenzimi i kryetarëve të këshillave lokale

1. Për punën e tyre kryetarët e këshillave lokale kompensohen nga buxheti i komunës përkatëse, dhe atë në shumën ekuivalente të anëtarëve të komiteteve obligative.
2. Kompensimi për pjesëmarrjen vetëm për (6) takime të këshillit lokal të mbajtura brenda vitit kalendarik, dhe atë në bazë të listës të nënshkruar nga pjesëmarrësit dhe procesverbalet nga takimi/et e mbajtura.

Neni 16

Dispozitat kalimtare, shfuqizuese dhe përfundimtare

Në rast konflikti të dispozitave të kësaj rregulloreje me Ligjin për vetëqeverisjen lokale dhe Statutin e Komunës mbizotrojnë dispozitat e ligjit dhe Statutit.

Neni 17

1. Ndryshimet dhe plotësimet eventuale në këtë rregullore do të bëhen sipas procedurës së njëjtë të aprovimit të kësaj rregulloreje.
2. Për zbatimin e kësaj rregulloreje kujdeset Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës.

Neni 18

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas rexhstrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafit 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Podujevë,
Gusht 2020



Shtojca

Rrugët sipas Këshillave lokale urbane

	KODI I RRUGËS	EMRI I RRUGËS	ZONA
1	18_10060	ZAHIR PAJAZITI	QENDRA 1
2	18_10037	NUHI GASHI	QENDRA 1
3	18_10032	ILIR KONUSHEVCI	QENDRA 1
4	18_11118	XHEMAJL MUSTAFA	QENDRA 1
5	18_10047	RAMADAN M SALIHU	QENDRA 1
6	18_10208	XHAFER META	QENDRA 1
7	18_10002	PROF NEXHMI SEJDIU	QENDRA 1
8	18_10061	SAHIT FUSHA	QENDRA 1
9	18_10059	QEFER SADIKU	QENDRA 1
10	18_10008	ANTON ÇETTA	QENDRA 1
11	18_10062	MARTIRËT BOGUJEVCI	QENDRA 1
12	18_10058	XHELADIN REKALIU	QENDRA 1
13	18_10001	19 QËRSHORI	QENDRA 1
14	18_10010	BAHRI FAZLIU	QENDRA 1
15	18_10004	AGRON RRAHMANI	QENDRA 1
16	18_10003	AFRIM ZHITIA	QENDRA 1
17	18_10022	FAHRI FAZLIU	QENDRA 1
18	18_10014	BESNIK RESTELICA	QENDRA 1
19	18_10114	SALIH ÇITAKU	QENDRA 1
20	18_10011	BEDRI BAJRAMI	QENDRA 1
21	18_10210	MET PODJEVA	QENDRA 1
22	18_10212	BEJTUSH PODJEVA	QENDRA 1
23	18_10213	TIRONA	QENDRA 1
24	18_10017	HAJREDIN UKELLI	QENDRA 1
25	18_10054	VËLLEZËRIT FRASHËRI	QENDRA 1
26	18_10053	DR ALI HADRI	QENDRA 1
27	18_11201	DR SHAQIR SHAQIRI	QENDRA 1
28	18_10211	FAZLI FETAHU	QENDRA 1
29	18_10055	XHORXH BUSH	QENDRA 1
30	18_10087	MUHAMET ALIU	QENDRA 1
31	18_11160	RAMUSH RAMA	QENDRA 1
32	18_10083	2 KORRIKU	QENDRA 1
33	18_10061	SAHIT FUSHA	QENDRA 1
34	18_10007	ALI AJETI	QENDRA 1
35	18_10040	JUSUF KOLIQI	QENDRA 1
36	18_10025	HAKIF ZEJNULLAHU	QENDRA 1

	KODI I RRUGËS	EMRI I RRUGËS	ZONA
1	18_10063	SHEMSI RAMA	QENDRA 2 VERI
2	18_10064	XHEMAIL XHELADINI	QENDRA 2 VERI
3	18_10025	HAKIF ZEJNULLAHU	QENDRA 2 VERI
4	18_10065	MUSTAFË HOXHA	QENDRA 2 VERI
5	18_12938	BAJRAM JETULLAHU	QENDRA 2 VERI
6	18_10005	AHMET HAXHIU	QENDRA 2 VERI
7	18_12001	ABIT SINANI	QENDRA 2 VERI
8	18_11166	XHON BELLUSHI	QENDRA 2 VERI
9	18_10056	VLORA	QENDRA 2 VERI
10	18_10012	TAHIR SINANI	QENDRA 2 VERI
11	18_10033	MIRSAD GASHI	QENDRA 2 VERI
12	18_11203	BILL KLINTON	QENDRA 2 VERI
13	18_10026	HASAN PRISHTINA	QENDRA 2 VERI
14	18_10068	ESET MALOKU	QENDRA 2 VERI
15	18_10114	SALIH ÇITAKU	QENDRA 2 VERI
16	18_10117	SABEDIN HASANI	QENDRA 2 VERI
17	18_12695	RAGIP ÇITAKU	QENDRA 2 VERI
18	18_12695	SHEFQET BULLIQI	QENDRA 2 VERI
19	18_10116	IDRIZ HASANI	QENDRA 2 VERI
20	18_10115	LIBURNIA	QENDRA 2 VERI
21	18_10083	2 KORRIKU	QENDRA 2 VERI
22	18_10113	BEDRI SOKOLI	QENDRA 2 VERI
23	18_10112	MANÇESTERI	QENDRA 2 VERI
24	18_10082	NAIM KADRIU	QENDRA 2 VERI
25	18_11202	EJUP SHALA	QENDRA 2 VERI

	KODI I RRUGËS	EMRI I RRUGËS	ZONA
1	18_10011	BEDRI BAJRAMI	QENDRA 2 JUGË
2	18_11205	AZEMINE DABINOVCI	QENDRA 2 JUGË
3	18_10075	GJON SERREQI	QENDRA 2 JUGË
4	18_10006	HAKIF SHEHOLLI	QENDRA 2 JUGË
5	18_12345	FEHMI AGANI	QENDRA 2 JUGË
6	18_10024	SHAKADIN BEHRAMI	QENDRA 2 JUGË
7	18_10080	SHOTË GALICA	QENDRA 2 JUGË
8	18_10079	AVNI RRUSTEMI	QENDRA 2 JUGË
9	18_10078	ESAD MEKULI	QENDRA 2 JUGË
10	18_10076	NEODARDANIA	QENDRA 2 JUGË
11	18_10093	ANTON ZAKO ÇAJUPI	QENDRA 2 JUGË
12	18_10007	ALI AJETI	QENDRA 2 JUGË
13	18_10088	ULQINI	QENDRA 2JUGË
14	18_10081	ADEM PODJEVA	QENDRA 2 JUGË
15	18_10090	JOSIP V RELA	QENDRA 2 JUGË
16	18_10091	PLAVA E GUCIA	QENDRA 2 JUGË
17	18_10092	VISAR THAÇI	QENDRA 2 JUGË
18	18_10039	LORDI BAJRON	QENDRA 2 JUGË
19	18_10094	AHMET SHABANI	QENDRA 2 JUGË
20	18_10125	LUIGJ GURAKUQI	QENDRA 2 JUGË
21	18_10084	BISLIM E NEZIR RESTELICA	QENDRA 2 JUGË
22	18_10035	KONGRESI I MANASTIRIT	QENDRA 2 JUGË
23	18_10036	OSMAN LATIFI	QENDRA 2 JUGË
24	18_10041	NAZIM GAFURRI	QENDRA 2 JUGË
			QENDRA 2 JUGË

	KODI I RRUGËS	EMRI I RRUGËS	ZONA
1	18_10009	AVDYLA LAHU	QENDRA 3 VERI
2	18_10044	RAMË GOVORI	QENDRA 3 VERI
3	18_11206	FEHMI ZYMERI	QENDRA 3 VERI
4	18_10052	MRETRESHA TEUTË	QENDRA 3 VERI
5	18_10020	LEKË DUKAGJINI	QENDRA 3 VERI
6	18_10029	HYZRI TALLA	QENDRA 3 VERI
7	18_11204	BAHTIR TALLA	QENDRA 3 VERI
8	18_10034	ISMAIL QEMALI	QENDRA 3 VERI
9	18_10140	HILMI BESHOLLI	QENDRA 3 VERI
10	18_10073	FADIL VATA	QENDRA 3 VERI
12	18_10074	QAZIM ASLLANI	QENDRA 3 VERI
13	18_10142	NAZMI ISMAJLI	QENDRA 3 VERI
14	18_10141	SALI ÇEKU	QENDRA 3 VERI
15	18_10019	JUSUF GËRVALLA	QENDRA 3 VERI
16	18_10069	ARBËRIA	QENDRA 3 VERI
17	18_10071	EDMOND HOXHA	QENDRA 3 VERI
18	18_10070	JAHË FUSHA	QENDRA 3 VERI
19	18_10119	RAMADAN MURATI	QENDRA 3 VERI
20	18_11165	KUVENDI I BUJANIT	QENDRA 3 VERI
21	18_10032	ILIR KONUSHEVCI	QENDRA 3 VERI
22	18_10143	MURSEL DABINOVCI	QENDRA 3 VERI
23	18_10144	SKENDER ZEJNULLAHU	QENDRA 3 VERI
24	18_11169	MARIN BARLETI	QENDRA 3 VERI
25	18_11209	XHAVIT HAZIRI	QENDRA 3 VERI
26	18_11208	FAVZI RAMA	QENDRA 3 VERI
27	18_11207	SHABAN R SFISHTA	QENDRA 3 VERI
28	18_10023	FITORJA	QENDRA 3 VERI
29	18_11170	KADRI ZEKA	QENDRA 3 VERI
30	18_10016	ÇAMËRIA	QENDRA 3 VERI
31	18_10146	GJON BUZUKU	QENDRA 3 VERI
32	18_10147	LIDHJA E FSHATIT	QENDRA 3 VERI
33	18_11118	XHEMAJL MUSTAFA	QENDRA 3 VERI
34	18_10072	UNIVERSI	QENDRA 3 VERI
35	18_10028	HAXHI SADRI BLAKU	QENDRA 3 VERI
36	18_10070	JAHË FUSHA	QENDRA 3 VERI
37	18_10018	DËSHMORËT	QENDRA 3 VERI
38	18_11130	BAJRAM METOLLI	QENDRA 3 VERI
39	18_12713	MIFTAR ZEJNULLAHU	QENDRA 3 VERI
40	18_10204	ISMET DËRGUTI	QENDRA 3 VERI
41	18_10205	FEHMI MIFTARI	QENDRA 3 VERI
42	18_10045	REMZI DEMOLLI	QENDRA 3 VERI
43	18_10138	ARAT E MELISHTËS	QENDRA 3 VERI
44	18_12000	HYSEN KASTATI	QENDRA 3 VERI
45	18_10192	MEHDI SETA	QENDRA 3 VERI
46	18_11211	DRITON DEMIRI	QENDRA 3 VERI
47	18_11229	DRAGOBIA	QENDRA 3 VERI
48	18_11228	VOSKOPOJA	QENDRA 3 VERI

49	18_10015	PROF NEXHMI SEJDIU	QENDRA 3 VERI
50	18_10139	HAMDI MALOKU	QENDRA 3 VERI

	KODI I RRUGËS	EMRI I RRUGËS	ZONA
1	18_10031	IBRAHIM DEMOLLI	QENDRA 3 JUGË
2	18_10203	MULLA DEMA	QENDRA 3 JUGË
3	18_10201	BAHRIE AHMETI	QENDRA 3 JUGË
4	18_10202	ILIRIA	QENDRA 3 JUGË
5	18_11215	PLEQNARËT E LLAPIT	QENDRA 3 JUGË
6	18_10200	NËNË TEREZA	QENDRA 3 JUGË
7	18_10050	SKËNDERBEU	QENDRA 3 JUGË
8	18_10197	FEHMI PERANI	QENDRA 3 JUGË
9	18_10196	HAMIT ABDULLAHU	QENDRA 3 JUGË
10	18_10198	ELFIR BEHRAMI	QENDRA 3 JUGË
12	18_10195	AHMET POPOVA	QENDRA 3 JUGË
13	18_10194	OSMAN POLLATA	QENDRA 3 JUGË
14	18_10046	AJET DURIQI	QENDRA 3 JUGË
15	18_10021	EMIN DURAKU	QENDRA 3 JUGË
16	18_10021	SHKËMBI	QENDRA 3 JUGË
17	18_10223	KRUJA	QENDRA 3 JUGË
18	18_10224	BAJRUSH MURATI	QENDRA 3 JUGË
19	18_10227	DHEU I KUQ	QENDRA 3 JUGË
20	18_10225	ALBANA	QENDRA 3 JUGË
21	18_11174	TABET E LLAPASHTICËS	QENDRA 3 JUGË
22	18_10043	QËNDRESA	QENDRA 3 JUGË
23	18_10229	RASHIT AJVAZI	QENDRA 3 JUGË
24	18_10228	PERMETI	QENDRA 3 JUGË
25	18_10221	VILSON	QENDRA 3 JUGË
26	18_10220	PREVEZA	QENDRA 3 JUGË
27	18_11172	KUVENDI I LEZHËS	QENDRA 3 JUGË
28	18_10230	BUNA	QENDRA 3 JUGË
29	18_10048	SABIT RRAHIMI	QENDRA 3 JUGË
30	18_10042	LUGINA E PRESHEVËS	QENDRA 3 JUGË
31	18_11175	MBRETI BARDHYL	QENDRA 3 JUGË
32	18_10107	BEDRI AHMETI	QENDRA 3 JUGË
33	18_10060	ZAHIR PAJAZITI	QENDRA 3 JUGË
34	18_10295	JASHAR EREBARA	QENDRA 3 JUGË
35	18_10313	VËLLEZËRIT TOVËRLANI	QENDRA 3 JUGË
36	18_10013	BESIANA	QENDRA 3 JUGË
37	18_10038	DËSHMORËT BABATINCA	QENDRA 3 JUGË
38	18_10290	DËSHMORËT STUBLLA	QENDRA 3 JUGË
39	18_10291	EDI DURHAM	QENDRA 3 JUGË
40	18_10292	SHTEGTARËT E LIRISË	QENDRA 3 JUGË
41	18_10293	MOTRAT QIRIAZI	QENDRA 3 JUGË
42	18_10294	ISMAJL ABDULLAHU	QENDRA 3 JUGË
43	18_10106	AVDULLAH BESELICA	QENDRA 3 JUGË
44	18_11226	PRESPA	QENDRA 3 JUGË
45	18_10051	RAIF HALITI	QENDRA 3 JUGË

46	18_10057	BUSH SFEQLA	QENDRA 3 JUGË
47	18_11200	SAMI RAMA	QENDRA 3 JUGË
48	18_10109	MON BALAJ	QENDRA 3 JUGË
49	18_10054	VËLLEZËRIT FRSHËRI	QENDRA 3 JUGË
50	18_10108	HIMARA	QENDRA 3 JUGË
51	18_10110	MUSTAFË BLAKU	QENDRA 3 JUGË
52	18_10111	ELBASANI	QENDRA 3 JUGË
53	18_10206	SYLEJMAN MEHMETI	QENDRA 3 JUGË
54	18_10041	NAZIM GAFURRI	QENDRA 3 JUGË
55	18_10302	NIMON ALIU	QENDRA 3 JUGË
56	18_10300	RAMË VLLASA	QENDRA 3 JUGË
57	18_10299	AVDUSH HASANI	QENDRA 3 JUGË
58	18_10298	SHKËLZEN HARADINAJ	QENDRA 3 JUGË
59	18_10301	DR BAHTIR SHEHOLLI	QENDRA 3 JUGË
60	18_10297	MEDLIN OLBRAJT	QENDRA 3 JUGË
61	18_12459	RIFAT PODJEVA	QENDRA 3 JUGË
62	18_10296	SALIH BUÇA	QENDRA 3 JUGË
63	18_11120	GRYKA E LLAPIT	QENDRA 3 JUGË
64	18_10095	BEKIM LUSHAKU	QENDRA 3 JUGË
65	18_10030	HYS POPOVA	QENDRA 3 JUGË
66	18_10096	HABIB ZEKA	QENDRA 3 JUGË
67	18_11177	NURË SHATRI	QENDRA 3 JUGË
68	18_10073	FADIL VATA	QENDRA 3 JUGË
69	18_10310	SKENDER H GASHI	QENDRA 3 JUGË
70	18_10097	XHAFER UKA	QENDRA 3 JUGË
71	18_10098	BRAHË HERTICA	QENDRA 3 JUGË
72	18_10099	GJERGJ FISHTA	QENDRA 3 JUGË
73	18_10100	UKSHIN HOTI	QENDRA 3 JUGË
74	18_10101	XHEVAT JUPOLLI	QENDRA 3 JUGË
75	18_10103	MBRETI GLAUK	QENDRA 3 JUGË
76	18_10095	BEKIM LUSHAKU	QENDRA 3 JUGË
77	18_10105	FATMIR HYSANI	QENDRA 3 JUGË
78	18_10104	LULET E LIRISË	QENDRA 3 JUGË
79	18_10102	XHAFER RRAHMAN MEHMETI	QENDRA 3 JUGË

	KODI I RRUGËS	EMRI I RRUGËS	ZONA
1	18_12345	FEHMI AGANI	QENDRA KOPSHTI LINDOR